

TRANSPARENCA DHE PËRGJEGJËSIA NË NIVEL VENDOR

VLERËSIMI I PROCESEVE TË KONSULTIMIT PUBLIK

Përmbledhje Krahasuese Ligjore në bashkitë:
Tiranë, Durrës, Vlorë, Pukë, Elbasan, Fier, Kukës,
Shkodër, Vau i Dejës, Korçë

PËRGATITUR NGA:
RRJETI "PËRBALLJA E OFERTAVE POLITIKE" (POP)
KORRIK 2024

Raport Studimor

“Transparenca dhe Përgjegjësia në Nivel Vendor - Vlerësimi i Proceseve të Konsultimit Publik në Nivel Vendor”

Përmbledhje Krahasuese Ligjore mbi studimin në bashkitë:

Tiranë, Durrës, Vlorë, Pukë, Elbasan, Fier, Kukës, Shkodër, Vau i Dejës, Korçë

Rrjeti Përballja e Ofertave Politike (POP) Korrik, 2024

1. Tabela e Përmbajtjes

1.	TABELA E PËRMBAJTJES	2
2.	LISTA E SHKURTIMEVE	3
3.	HYRJE.....	4
4.	METODOLOGJIA E STUDIMIT	5
5.	QEVERISJA VENDORE	7
6.	KUADRI LIGJOR QË RREGULLON PROCESIN E NJOFTIMIT DHE KONSULTIMIT PUBLIK NË SHQIPËRI.....	8
	6.1 Përshkrim i shkurtër i dizpozitave të ligjit “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”	8
	6.2 Problematika të ligjit “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”	10
7.	PËRMIRËSIMI I VENDIMARRJES LOKALE NË ZBATIM TË STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE PËR DECENTRALIZIMIN DHE QEVERISJEN VENDORE 2023–2030	12
8.	ANALIZA LIGJORE E GJETJEVE TË STUDIMIT	13
	8.1 Komentet dhe rekomandimet e marra gjatë procesit të konsultimit publik	13
	8.2 “Stacioni” ligjor për grumbullimin e komenteve dhe rekomandimeve	14
	8.3 Raportet për transparencën në procesin e vendimmarrjes	16
9.	KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME:.....	18
10.	REFERENCAT:.....	19
	10.1 Burime parësore	19
	10.2 Burime dytësore:	20
11.	ANEKSE: RAPORTET STUDIMORE TË BASHKIVE TIRANË, DURRËS, VLORË, PUKË, ELBASAN, FIER, KUKËS, SHKODËR, VAU I DEJËS, KORÇË, “TRANSPARENCA DHE PËRGJEGJËSIA NË NIVEL VENDOR - VLERËSIMI I PROCESEVE TË KONSULTIMIT PUBLIK”.	20

2. Lista e Shkurtimeve

AMVV	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore
BP	Buxheti me Pjesëmarrje
KB	Këshilli Bashkiak
KDIMDP	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
NED	National Endowment for Democracy
Nj.A	Njësi Administrative
NJVQV	Njësi e Vetëqeverisjes Vendore
OPIC	Olof Palme International Center
OSHC	Organizatë e Shoqërisë Civile
PBA	Projekt Buxheti Afatëmesëm
POP	Përballja e Ofertave Politike
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak

3. Hyrje

Angazhimi dhe përfshirja e qytetarëve në konsultim dhe vendimmarrje përbën një nga elementët kryesorë drejt zhvillimit të qëndrueshëm dhe qeverisjes së mirë, ku zëri i të gjithëve dëgjohej gjatë gjithë procesit të vendimmarrjes, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose përmes organizatave të shoqërisë civile tek institucionet përgjegjëse. Pjesëmarrja aktive e qytetarëve garanton identifikimin e problemeve dhe nevojave reale, përfshirjen e njohurive dhe përvojave të të gjithë aktorëve, duke i bërë ata të ndihen përgjegjës për çështje të përbashkëta, duke rritur besueshmërinë dhe transparencën për krijimin e mundësive për zgjidhje të qëndrueshme.

Roli dhe kontributi i pazëvendësueshëm i qytetarëve dhe komuniteteve në proceset qeverisëse është kyç për arritjen e një qeverisjeje sa më demokratike, ndërkohë që bashkitë përmes zbatimit efektiv të ligjit dhe politikave të duhura e gjithëpërfshirëse sigurojnë zhvillim të qëndrueshëm, përfshirje dhe kohezion social.

Është misioni i qeverisjes vendore të sigurojë një administrim sa më pranë qytetarëve të saj dhe të nxisë pjesëmarrjen e tyre efektive në të, ndërkohë që ushtrimi i qeverisjes dhe përmirësimi i cilësisë së jetës nuk mund dhe nuk duhet të jenë e drejtë ekskluzive e saj. Për sa kohë që ekzistojnë mekanizma dhe modele të mirëqeverisjes, bashkitë duhet të vijojnë të kërkojnë, adaptojnë e praktikojnë alternativa dhe forma ku qytetarët, grupet e interesit dhe shoqëria civile shihen si partnerë të domosdoshëm të këtij procesi.

Studimi “Transparenca dhe Përgjegjësia në Nivel Vendor - Vlerësimi i Proceseve të Konsultimit Publik” zhvillohet në kuadër të vlerësimit të situatës ekzistuese në lidhje me praktikën e njoftimit dhe konsultimit publik në nivel vendor. Ai zhvillohet nga Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike”¹ (POP) në kuadër të projektit “Nxitja e Mbikëqyrjes Qytetare mbi Përgjegjshmërinë Politike” financuar nga National Endowment for Democracy dhe Olof Palme International Center.

Rrjeti POP përmes këtij programi synon të përmirësojë qeverisjen dhe përdorimin e përgjegjshëm të burimeve publike, si dhe mbrojtjes efektive të të drejtave të njeriut, nëpërmjet forcimit të kapaciteteve të Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC) për të ndikuar në proceset e politikave të përfaqësuesve të tyre vendorë bashkiakë.

Organizatave anëtare² të Rrjetit POP, veprojnë si grupe presioni për të advokuar në qeveritë e tyre vendore për të identifikuar prioritetet e zhvillimit, në mënyrë që politikën dhe programet të bazohen në nevojat lokale, si dhe në mundësitë dhe kapacitetet e disponueshme.

Nën këtë optikë në periudhën maj – qershor 2024, është realizuar studimi “Transparenca dhe Përgjegjësia në Nivel Vendor - Vlerësimi i Proceseve të Konsultimit Publik”.³

Studimi “Transparenca dhe Përgjegjësia në Nivel Vendor - Vlerësimi i Proceseve të Konsultimit Publik në Vlorë” vlerësoi situatën e realizimit të Ligjit të Njoftimit dhe Konsultimit Publik për

¹ Faqe zyrtare e Rrjetit POP: <https://popnetwork.al/>

² Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim”, Tiranë; Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës; Qendra Rinore Vlorë, Epoka e Re, Fier; Intelktualët e Rinj Shpresë, Shkodër; Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë; Qendra Rinore për Progres, Kukës, Gruaja në Zhvillim, Korçë; Hapa të Lehtë, Vau i Dejës; Tjetër Vizion, Elbasan

³ Raportet Studimore për bashkitë: Tiranë, Durrës, Vlorë, Pukë, Elbasan, Fier, Kukës, Shkodër, Vau i Dejës, Korçë

periudhën shtator 2023 – maj 2024, përmes monitorimit të dëgjesave publike duke nxitur diskutimin midis aktorëve të përfshirë për njohjen dhe zbatimin e ligjit, si dhe përgatiti disa rekomandime konkrete në nivel të Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore (NjVQV). Organizatat partnere e realizuan këtë studim në Tiranë, Durrës, Vlorë, Pukë, Elbasan, Fier, Kukës, Shkodër, Vau i Dejës, Korçë, për të pasqyruar situatën e realizimit të njoftimit dhe konsultimit publik në këto njësi të qeverisjes vendore. Gjetjet dhe rekomandimet do të shërbejnë për të marrë një informacion më të thelluar për mekanizmat e identifikuar të Ligjit të Njoftimit dhe Konsultimit në nivel vendor, sfidat, vështirësitë dhe rastet e suksesit në zbatimin e tij. Rrjeti POP në një fazë të mëvonshme do të punojë dhe me institucionet mbikqyrëse për të ndarë gjetjet e studimit, siç janë Prefekturat, Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale si dhe Kontrollin e Lartë të Shtetit.

4. Metodologjia e Studimit

Për përgatitjen e vlerësimit në lidhje me zbatimin e Ligjit të Njoftimit dhe Konsultimit publik (ligji nr. 146/2014⁴) në të dhjetë bashkitë e monitoruara, u kombinuan një sërë mjeteve dhe metodologjish duke përfshirë:

- Analizimin e Gjetjeve të Raportit Studimor “Informimi, Njoftimi dhe Konsultimi Publik” realizuar nga Rrjeti POP në vitin 2022 për të njëjtat bashki.
- Rishikimin e dokumenteve strategjike, publikimet në regjistrin elektronik për konsultimet, publikimet në programin e transparencës, raporte të prodhuara dhe bazat e të dhënave në të gjitha fazat mbi procesin e njoftimit dhe konsultimit publik në nivel vendor;
- Hulumtimi i raporteve dhe mekanizmave të kontrollit të Prefekturës përkatëse; Kontrollit të Lartë të Shtetit si edhe të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP) për monitorimin e zbatimit të ligjit të njoftimit dhe konsultimit publik në nivel vendor.
- Kërkesa zyrtare për informacion drejtuar Kryetarit të bashkisë në dhjetë bashkitë nën monitorim.
- U realizuan në total 50 intervista të drejtpërdrejta me stafet e bashkive
- Pesëdhjetë intervista të thelluara me anëtarë të këshillave bashkiakë respektivë.
- Rreth 285 intervista të thelluara me aktivistë/përfaqësues të komunitetit dhe qytetarë sipas bashkive.
- 1342 qytetarë iu përgjigjën pyetësorit online.

Pyetësorët përmbajnë pyetje rreth temave që lidhen me: urdhërat e brendshëm për fillimin e procedurës së konsultimit publik; përgatitja dhe publikimi i kalendarit të konsultimit publik; njoftimi i konsultimit publik; realizimi i konsultimit; përgatitja dhe publikimi i procesverbaleve, ndikimi i rekomandimeve të qytetarëve dhe grupeve të interesit në vendimet përfundimtare të aprovuara nga vendimarrësit si dhe publikimi i raportit të konsultimit publik në regjistrin elektronik. Në lidhje me qytetarët dhe grupet e interesit përmes pyetësorëve është vlerësuar

⁴ Ligji për Njoftimin dhe Konsultimin Publik: <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2014/10/30/146/3923aec7-2287-4909-9119-ea5dcee6245e>

efektiviteti i procesit të konsultimit publik, si reflektohen rekomandimet e tyre dhe si ndikon në jetën e qytetarëve vendimet që nuk konsultohen me proces të pjesëmarrëse.

Pyetësorët e shpërndarë përmbajnë pyetje cilësore dhe sasore duke mbajtur në vëmendje ekspertizën lokale të organizatave të rrjetit POP, në çështje të qeverisjes vendore dhe angazhimit qytetar. Për përgatitjen e pyetësorve ekspertët e organizatave lokale konsideruan faktorë të rëndësishëm që ndikojnë në cilësinë e sondazhit, të tilla si: objektivi i përgjithshëm i anketimit dhe konteksti lokal (të dhënat informacionet ekzistuese) për të mundësuar një kuptim më të mirë të situatës dhe çështjeve.

Gjithashtu u trajnuan 10 përfaqësues të organizatave lokale, për të zhvilluar intervistat në terren. Intervistat kërkuan të sigurojnë marrjen e informacioneve në aspektin gjeografik, të moshës dhe gjinisë. Intervistuesit zhvilluan intervista të drejtpërdrejta, duke drejtuar pyetjet personalisht dhe duke plotësuar në vend pyetësorët.

Burimi kryesor i informacionit në lidhje me shqyrtimin e dokumenteve strategjike, raporteve të prodhuara dhe zbatimit të fazave të procesit të njoftimit dhe konsultimit publik janë faqet zyrtare të internetit të bashkive dhe këshillave bashkiakë respektivë të përzgjedhura në studim, rregulloret e brendshme dhe publikimi i njoftimeve dhe dokumentacionit lidhur me konsultimet publike të zhvilluara, por edhe raportet e prodhuara nga institucione ndërkombëtare apo organizata të shoqërisë civile.

Në lidhje me mekanizmat e kontrollit të zbatimit të ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik, ekspertët dhe organizatat e përfshira në projekt kanë hulumtuar dokumentet e prodhuara nga institucionet që monitorojnë drejtpërdrejtë zbatimin e ligjit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik si institucioni i Prefektit, Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të dhënave Personale.

Ky raport i përbashkët me gjetjet nga 10 bashkitë: Tiranë; Durrës; Elbasan; Vlorë; Fier; Vau i Dejës; Korçë; Pukë; Kukës; Shkodër është hartuar me metodën krahasuese dhe do të shërbejë për të evidentuar progresin e arritur duke analizuar të dhënat e grumbulluara nga gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e arritura nga raporte të mëparshme duke përdorur indikatorë sasiorë dhe cilësorë si burime primare⁵ dhe sekondare⁶ për grumbullimin e informacionit.

Gjetjet dhe rekomandimet e raportit do të synojnë përmirësimin e situatës aktuale nëpërmjet masave që autoritetet vendore duhet të ndërmarrin në lidhje me zbatimin e ligjit dhe propozime për ndryshime ligjore për ta bërë procesin sa më interaktiv dhe gjithëpërfshirës.

⁵ Si burime primare të informacionit u përdor ligji nr.146/2014, “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, informacioni në lidhje me procesin e konsultimit publik të publikuar në faqet zyrtare të bashkive respektive si edhe informacioni i përfituar nëpërmjet Kërkesave për Informim.

⁶ Si burime sekondare: u përdorën raporte të tjera në lidhje me procesin e konsultimit të cilat shërbyen në përgatitjen e analizës krahasuese të progresit në çdo bashki në lidhje me procesin e konsultimit.

5. Qeverisja vendore

Qeverisja lokale është pushteti më i afërt ndaj qytetarëve. Në kuptimin kushtetues kjo është cilësuar si “vetqeverisje”. Në paragrafin 4, neni 108 të Kushtetutës së Shqipërisë është përcaktuar se: “Vetëqeverisja në njësitë vendore ushtrohet nëpërmjet organeve të tyre përfaqësuese dhe referendumeve vendore”⁷. Pra nga përcaktimi që i bën Kushtetuta rezultojnë dy institucione vendimarrëse të rëndësishme nëpërmjet të cilave qytetarët mund të ushtrojnë vetqeverisjen vendore, të cilat janë:

- 1) *Organet përfaqësuese të njësite vendore*
- 2) *Referendumet vendore.*

Sipas Kartës Europiane të Autonomisë Vendore përcaktohet se: “Me autonomi vendore kuptohet e drejta dhe aftësia efektive e bashkësive vendore për të rregulluar e për të drejtuar brenda ligjit, nën përgjegjësinë e tyre dhe në të mirë të popullsive të tyre, një pjesë të mirë të çështjeve publike.”

Po lind pyetja nëpërmjet kujt mund të ushtrohet kjo e drejtë?

Praktika e Gjykatës Kushtetuese i ka dhënë përgjigje kësaj pyetje kur ka përkufizuar qeverisjen vendore si e drejta e njerëzve në bashkësinë e caktuar territoriale që në mënyrë të pavarur të qeverisin punët e tyre, nëpërmjet organeve të cilat i zgjedhin vetë, ose në mënyrë të drejtpërdrejtë⁸. Pra rezulton se ushtrimin e kësaj të drejte e kanë qytetarët. Ata mund ta ushtrojnë këtë të drejtë:

- a) *nëpërmjet organeve përfaqësuese të qeverisjes vendore të tilla si këshillat, asamblatë apo organe ekzekutive përgjegjëse para tyre.*
- b) *në mënyrë të drejtpërdrejtë nëpërmjet kuvendeve, referendumeve apo çdo formë tjetër të pjesmarrjes së drejtpërdrejtë të tyre*⁹.

Prandaj duke qenë se parimi i autonomisë vendore afron qeverisjen më pranë qytetarëve, rezulton që e drejta për të qeverisur punët e tyre i takon qytetarëve. Karta Europiane e Autonomisë Vendore u kërkon shteteve anëtare të drejtën që të garantohet nga legjislacioni i brendshëm dhe Kushtetuta¹⁰

Një nga instrumentet kryesore rregullatore të përdorura për të përmirësuar transparencën, efikasitetin dhe efektivitetin në procesin e hartimit të legjislacionit dhe politikave publike, bazuar në të dhëna dhe në vlerësimet mbi ndikimin rregullator është **Konsultimi publik**.

⁷ Shih: neni 3, pika 1, e Kartës Europiane të Autonomisë Vendore

⁸ Shih: Vendimi nr. 29, datë 21.12.2006 i Gjykatës Kushtetuese Shqiptare, fq 13

⁹ Shih: neni 3, pika 2, e Kartës Europiane të Autonomisë Vendore

¹⁰ Shih neni 2 i Kartës Europiane të Autonomisë Vendore

Konsultimi publik është mekanizmi që mundëson përfshirjen e publikut, grupeve të interesit, biznesit, komunitetit akademik, ekspertëve dhe medias në vendimarrje duke siguruar përfshirjen e tyre gjatë gjithë procesit të politikëbërjes, me qëllim krijimin e politikave të cilat janë me cilësi të lartë në përmbajtje, që reflektojnë nevojat e shoqërisë dhe që sigurojnë zhvillim¹¹.

6. Kuadri ligjor që rregullon procesin e Njoftimit dhe Konsultimit Publik në Shqipëri

Duke iu referuar ligjit organik për Vetëqeverisjen Vendore Nr.139/2015¹², bashkia si organ ekzekutiv dhe Këshilli Bashkiak si organ përfaqësues kanë detyrimin të sigurojnë transparencën e veprimtarive¹³ të tyre në procesin e vendimarrjes. Angazhimi i komunitetit në qeverisjen lokale, ndër të tjera, mundësohet përmes konsultimeve publike, duke sjellë në vëmendje përgjegjësitë e organeve vendore të njohin dhe zbatojnë në praktikë detyrimet që rrjedhin nga Ligji Nr. 146/2014 **“Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”**. Ky ligj rregullon marrëdhëniet për realizimin e procesit të konsultimit publik, në vendimarrjet që i përkasin hartimit të projektakteve, të tilla si projektligje, dokumente strategjike kombëtare dhe lokale, si dhe politika me interes të lartë publik. Zbatimi i këtij ligji rregullohet përkatësisht edhe me zbatimin e akteve të tjera nën ligjore ku më të rëndësishmet mund të përmendim, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 828/2015 **“Për miratimin e rregullave të krijimit dhe administrimit të Regjistrisë Elektronike për Njoftimet dhe Konsultimet Publike”**, Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 252, datë 20.4.2023, **“Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023–2030, të Planit të saj të Veprimit 2023-2025 e të pasaportës së indikatorëve”**

6.1 Përshkrim i shkurtër i dizpozitave të ligjit “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”¹⁴

Parlamenti Shqiptar më 30 Tetor 2014, ka miratuar një ligj mjaft të rëndësishëm **“Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”** i cili synon nxitjen e transparencës, të përgjegjshmërisë dhe integritetit të autoriteteve publike. Ky ligj i cili zbatohet për rregullat dhe procedurat e njoftimit e të konsultimit publik të cilat duhet që të zhvillohen nga organet publike në proceset politikbërëse dhe vendimarrëse ndikojnë drejtpërdrejtë në rritjen e pjesmarrjes së publikut në qeverisje. Duke përcaktuar rregullat proceduriale që duhen zbatuar, garantohet pjesmarrja e publikut në proceset politikbërëse dhe vendimarrëse të cilat zhvillohen dhe udhëhiqen nga organet publike. Një nga objektivat e këtij ligji është rregullimi i procesit të njoftimit dhe të konsultimit publik të projekt-dokumenteve strategjik kombëtare dhe vendore, si dhe politikave me interes të lartë publik¹⁵.

Në këtë ligj janë përfshirë edhe organet publike të pushtetit vendor të cilat kryejnë funksione administrative duke bazuar punën e tyre sipas disa parimeve të rëndësishme të cilat janë¹⁶

¹¹ Procesi i konsultimit publik në Shqipëri bazohet në ligjin nr.146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, si dhe në urdhrin nr.3, datë 29.1.2021, të Sekretarit të Përgjithshëm të Kryeministrit, “Për miratimin e udhëzuesit të konsultimit publik”.

¹² Burimi: <https://qbz.gov.al/eli/ligji/2015/12/17/139>

¹³ Neni 16 dhe neni 18 i ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

¹⁴ Ligji Nr. 146/2014, “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, miratuar më 30/10/2014 publikuar në fletore zyrtare nr 178 datë 24 Nëntorë 2014, faqe 9189

¹⁵ Shih: pika 1, neni 1, Ligji Nr. 146/2014, datë 30/10/2014, “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”,

¹⁶ Po aty, neni 5

- a) **transparenca** gjatë procesit të njoftimit e të konsultimit publik me pjesmarrje gjithpërfshirëse dhe jodiskriminuese;
- b) **efektshmëria** e procesit të vendimmarrjes në organet publike;
- c) **përgjegjësia** e organeve publike ndaj palëve të interesuara.

Procesi i konsultimit, të cilit për herë të parë i është bërë një rregullim i veçantë ligjor, mund të konsiderohet si një proces i institucionalizuar i shkëmbimit të informacionit. Por ligji “Konsultimin publik” e ka përkufizuar si:

“ tërheqja e mendimeve dhe sygjerimeve të palëve të interesuara për përmbajtjen dhe përmirësimin e projekt-aktit, nga momenti i publikimit të projekt-aktit deri në miratimin përfundimtar të tij.”¹⁷

Prandaj, për të garantuar një proces konsultimi publik sa më gjithpërfshirës dhe për të garantuar pjesmarrjen e publikut në qeverisje, ligji detyron organet e autoritetit publik të kryejnë një proces sa më transparent. Këto autoritete duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme për të informuar nëpërmjet **publikimeve në regjistrin elektronik të projekt-aktit, si dhe në programin e transparencës, të planeve vjetore të organeve publike** që lidhen me procesin e vendimmarrjes.

Gjithashtu, ato duhet të informojnë në lidhje me procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik në të gjitha fazat, duke filluar nga publikimi i projekt-aktit e deri te miratimi i aktit përfundimtar. Gjatë këtij procesi, ato duhet të ofrojnë të gjithë informacionin e nevojshëm për të krijuar mundësinë efektive të kontributit, për të gjitha palët e interesuara.

Në nenin 8 të këtij ligji, ku përcaktohen se kush mund të jenë palët e interesuara, bie në sy fakti që ligji ja njeht këtë të drejtë edhe grupeve të interesit, por duke mos u shprehur nëse këto grupe mund të jenë me personalitet juridik apo thjesht grupe informale që përfaqësojnë një interes të caktuar. Ligji është shprehur në mënyrë më eksplicite në përcaktimin e personave të huaj, duke i njohur si palë qoftë ato fizikë dhe juridikë.

Natyrshëm që një nga të drejtat kryesore që palët kanë në përcaktimet e këtij ligji, është e drejta e informimit. Në ushtrimin e kësaj të drejte ato mund të njihen me projektaktin si dhe mund të propozojnë fillimin e procedurës për hartimin dhe miratimin e projektakteve apo të bëjnë komente dhe të adresojnë rekomandime¹⁸. Por si gjithmonë çdo e drejtë ka edhe kufijtë e saj, prandaj edhe në këtë ligj parashikohen kufizime të caktuara. Në ligj është parashikuar se pjesmarrja e publikut mund të kufizohet kryesisht në ato raste të cilat lidhen me sigurinë kombëtare. Një nga risitë e këtij ligji është edhe fakti se sanksionohet dhënia e informacionit në lidhje me procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik në të gjitha fazat, ku përfshihet:

- a) **publikimi i projekt-aktit,**
- b) **marrja e komenteve dhe rekomandimeve për përmirësimin e tij,**
- c) **organizimi i debateve publike,**
- d) **miratimi i aktit përfundimtar.**

¹⁷ Po aty neni 2, pika 5

¹⁸ Shih: neni 9, Ligji Nr. 146/2014, date 30/10/2014, “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”

Po ashtu një tjetër element që përfshihet në këtë ligj është edhe **krijimi i regjistrit elektronik**. Çdo projekt-akt duhet të publikohet në regjistrin elektronik të njoftimit dhe konsultimit publik. Nëpërmjet këtij regjistri sigurohet akses dhe ofrohet mundësia e komunikimit e të gjitha palëve të interesuara me organin publik. Ky regjistër do të shërbej si një pikë qendrore konsultimi. Kjo formë siguron dhe forcon barazinë për sa i përket aksesit në informacion dhe shërbim, duke pasur në vëmendje dhe nevojat specifike për persona apo grupime të caktuara.

Një tjetër element i rëndësishëm i parashikuar në këtë ligj është edhe organizimi i takimeve publike, në rastet kur kemi të bëjmë me takime të rëndësishme. Ligji ka parashikuar mënyrat e njoftimit, ndër të cilat **përfshihen komunikimet elektronike, mediat e shkruara dhe audiovizive, etj**¹⁹.

Ligji ka ngarkuar organin publik që të grumbulloj të gjitha sygjerimet e pjesmarrësve gjatë këtyre takimeve, dhe së bashku me sygjerimet e refuzuara t'i njoftoj sipas mënyrave të përcaktuara në këtë ligj. Në fund të çdo viti është e detyrueshme që të përpilohen raporte ku të prezantohen të dhëna në lidhje me aktet e miratura, sygjerimet e pranuar dhe ato të refuzuara. Shqyrtimi i ankesave në lidhje me respektimin e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj bëhet nga drejtuesi i autoritetit publik dhe Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, brenda një afati 30 ditor²⁰.

6.2 Problematika të ligjit “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”

Ky ligj përbën një arritje të re ligjore në drejtim të hapjes së qeverisjes dhe ngushtimit të hendekut të saj me qytetarët. Kjo përbën një tendencë serioze për përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje, duke zgjeruar hapsirën ligjore ku ato kanë mundësinë të shprehin alternativat e tyre dhe shqetësimet të cilat lidhen me vendimin që pritet të merret. Ky ligj ka kalur nje periudhë testimi në praktikë dhe nevoiten permiresime në drejtim të rritjes së efektivitetit të pjesmarrjes:

- 1) **Një ndër pikat kryesore**, që ky ligj nuk shprehet qartë, mbetet garancia e pjesmarrjes së publikut në qeverisje. Vërtet që janë parashikuar mënyrat e njoftimit, por shpesh ato nuk rezultojnë efikase dhe takimet përfundojnë të jenë formale dhe nuk sjellin rezultatet e pritshme. Nuk është e qartë sesi do të bëhet komunikimi elektronik, duke qenë se jo të gjithë qytetarët e kanë mundësinë e përdorimit të mjeteve elektronike. Në këtë rast, rezulton si domosdoshmëri ngritja e një database ku të gjithë të interesuarit, qytetarë apo grupe interesi mund të regjistrohen dhe të komunikojnë në mënyrë elektronike. Por përsëri në kushtet kur komunikimi elektronik nuk ka një rregullim të qartë ligjor edhe kjo formë mbart shumë pikpyetje. Një pikë tjetër ku ligji duhet të shprehet në mënyrë më të qartë është kur bëhet fjalë për çështje të rëndësishme. Takimet e hapura publike duhet të theksohet që prania e mediave duhet të jetë e detyrueshme, duke i dhënë atyre mundësinë e transmetimeve të drejtpërdrejtë pa cungime dhe censura të çfarëdo lloji.
- 2) **Po ashtu, ligji ka parashikuar si autoritetin e shqyrtimit të ankesave** në rastet e moszbatimit të këtij ligji titullarin e autoritetit publik dhe **Komisionerin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale**. Por besojmë që kjo nuk është e mjaftueshme. Në rastin e ankesave në nivel lokal, kjo zvogëlon mundësinë e ushtrimit të kësaj të drejte e sidomos kur bëhet fjalë për ato ankesa

¹⁹ Shih neni 11, Ligji Nr. 146/2014, datë 30/10/2014, “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”

²⁰ Shih: Po aty neni 21 i ligjit

drejtuar Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Ligji duhej që të kishte parashikuar në mënyrë eksplicite edhe rrugën gjyqësore si një mënyrë efektive ankimi, ashtu siç është parashikuar në ligjin **Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”**. Po ashtu duke qenë se ligji i njeh të drejtën autoriteteve lokale për të ngritur struktura në ushtrim të funksioneve të veta²¹, një mënyrë efikase dhe më e besueshme për shqyrtimin e këtyre ankesave mund të ishin strukturat administrative (këshillat apo dhomat administrative).

- 3) **Mënyra e shqyrtimit të sygjërimeve dhe sidomos i njoftimit të rasteve**, kur kemi të bëjmë me refuzimin e këtyre sygjërimeve nuk është shumë efikase dhe tendenca do të jetë drejtë një procesi formal. Për ta bërë sa më efektive, ligji duhet që të detyroj organin publik që të zhvilloj një takim të dytë me palët e interesuara ku të diskutohen dhe të jepen argumenta në lidhje me arsyet e refuzimit të këtyre sygjërimeve. Një praktikë e tillë mund të sjellë dy skenarë të prishëm të cilët janë:

- a) ***Palët bien dakort me argumentat, ku ose organi publik mund të bindet dhe pranon sygjërimet që t’i përfshij në akt ose publiku pranon që t’i tërheq këto sygjërime***
- b) ***Palët nuk bien dakort dhe nuk tërhiqen nga pozicionet fillestare***

Problemi më i vështirë për zgjidhje qëndron në **pikën b)**. Kjo përbën një problem më vete duke qenë se zgjidhja e këtij rasti demonstron vërtet modelin e një qeverisje demokratike e cila mbështetet tek qytetarët e saj. Prandaj në një rast të tillë ka shumë rëndësi të kuptohet arsyeja e sygjërimeve të refuzuara, në çfarë argumentash ligjor mbështetet, në çfarë mase qytetarët i mbështesin këto sygjërime. Në rastin kur sygjërimet kanë një bazë të mirë ligjore atëherë është e kuptueshme që edhe nëse sygjërimi nuk do pranohet atëherë gjykata mund të vendos përfshirjen e tyre, por edhe në këtë rast ligji nuk e ka parashikuar ankimin gjyqësor, prandaj kjo është një mangësi e këtij ligji në drejtim të përfshirjes së qytetarëve.

Në rastin tjetër, i përket organit vendimarrës të kuptoj se këto sygjërime gjejnë mbështetje tek masa e qytetarëve që preken nga kjo vendimmarrje. Prandaj mendojmë se në këte rast organit publik lokal, në varësi të rëndësisë së vendimmarrjes së aktit të cilin po trajton, mund t’i ofrohen tre alternativa në mënyrë që procesi të jetë sa më transparent dhe sa më gjithpërfshirës:

- a. Të organizojë takime më të zgjeruara me publikun për të marrë mbështetje sa më të gjerë.
- b. T’ja kalojë organit që është zgjedhur drejtpërdrejtë nga komuniteti lokal²² për një vendim përfundimtar.

Së fundi ligji nuk ka përcaktuar në një mënyrë të gjerë palët e interesuara. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ka përcaktuar se edhe personat juridik janë bartës së të drejtave dhe lirive themelore të përcaktuara në Kushtetutë²³. Në frymën e këtij interpretimi kushtetues përfshirja dhe përcaktimi në mënyrë ekskluzive edhe i personave juridikë si palë e interesuar është domosdoshmëri kushtetuese.

²¹ Shih gërma c, neni 8 të ligjit Nr.8652, datë 31/07/2000 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Qeverisjes Vendore”

²² Këshilli bashkiak ose Kryetarit i njësisë së qeverisjes vendore

²³ Shih: pika 2, neni 16 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

7. Përmirësimi i vendimarrjes lokale në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023–2030

Nëpërmjet vendimit Nr. 252, datë 20.4.2023, Qeveria ka miratuar **“Strategjinë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023–2030, të Planit të saj të Veprimtimit 2023–2025 e të pasaportës së indikatorëve”** Në këtë dokument strategjik është përcaktuar qartë se demokracia vendore do të përfitonte nga një përshkrim shterues i ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, për të qartësuar kompetencat e të gjithë organeve të qeverisjes vendore. Dokumenti synon t’i kushtojë rëndësi përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje, në kuadër të proceseve konsultuese të këshillit në përgjithësi apo dhe të vetë administratës vendore, duke e konsideruar përfshirjen e qytetarëve si një proces sistematik, domethënës dhe të buxhetuar. Çdo ndërhyrje për të konsoliduar e harmonizuar kuadrin ligjor, si dhe për të mbështetur këshillat bashkiakë në rritje kapacitetesh, në ndërtim e konsolidim të strukturave respektive administrative e menaxheriale, do të forconte demokracinë vendore duke intensifikuar ndërveprimin me institucionet në nivel qendror, rajonal e vendor, me qytetarët, strukturat komunitare dhe shoqërinë civile. Këshillat bashkiakë kanë nevojë të njohin më mirë jo vetëm punën e administratës, por dhe atë të institucioneve të tjera (p.sh. degë territoriale), mbi punën dhe performancën e të cilave duhet të japin gjykim, vlerësim dhe të ndërveprojnë. Këshillat dhe këshilltarët më të mirë janë ata që punojnë ngushtë me qytetarët dhe komunitetet.

Në këtë frymë strategjia synon të nxisë bashkëpunim me qëllim që qytetarëve t’u jepet më shumë vendimmarrje mbi komunitetin e tyre, të konsultohen dhe të përfshihen në vendimmarrje dhe aktivitetet e këshillit, të informohen dhe të vazhdojnë të ndikojnë për rritjen e cilësinë e shërbimeve në zonën e tyre.

Strategjia synon konsolidimin e procesit të decentralizimit për të fuqizuar qeverisjen vendore për zhvillim ekonomik të qëndrueshëm drejt standardeve evropiane, mbështetur mbi qëllimet politike kryesore të cilat kanë si objektiv:

1. ***Nxitjen dhe forcimin e zhvillimit të qëndrueshëm vendor;***
2. ***Përmirësimin e cilësisë, se standardeve dhe ofrimit të shërbimeve vendore;***
3. ***Zgjerimin e qeverisjes digjitale në nivel vendor për të ofruar shërbime dhe programe qeveritare në mënyrë më eficente, transparente dhe me kosto efektive;***
4. ***Rritjen e autonomisë financiare vendore nëpërmjet konsolidimit të sistemit të të ardhurave të veta;***
5. ***Përmirësimin e demokracisë vendore dhe përparimi i agjendës së integritimit evropian në nivel vendor;***
6. ***Zhvillimin dhe forcimin e kapaciteteve të nevojshme vendore dhe qendrore dhe i një koordinimi e qeverisjeje funksionale gjithëpërfshirëse të aktorëve të decentralizimit.***

Në kuadër të ndryshimeve/përmirësimeve ligjore, do të shihet mundësia e adresimit në përfaqësim më të “gjerë” gjeografik të anëtarëve të këshillit bashkiak, **si edhe adresim të**

çështjeve të lidhura me kuadrin ligjor për konsultimin publik dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrjen vendore.

Kjo do të mundësonte, *përveç përmirësimeve ligjore, edhe përdorimin e mekanizmave të tjerë që mundësojnë në mënyrë demokratike dhe transparente (duke përfshirë platforma elektronike) përfshirjen sistematike të komunitetit në veprimtarinë dhe në vendimmarrjen e këshillit bashkiak, si dhe në monitorimin e zbatimit të politikave vendore.*

Në fokus do të jenë edhe **strukturat komunitare** të zgjedhura në mënyrë demokratike, efikase dhe të informuara lidhur me rolin e tyre në bashkëpunim me organet e zgjedhura dhe ekzekutive.

Finalizimi i procesit të **hartimit të planeve vendore të integritetit dhe Kodit të Sjelljes** përfshin hartimin e planeve vendore të integritetit dhe miratimin e tyre pranë këshillave bashkiakë në të gjitha bashkitë e mbetura si pjesë e planit afatshkurtër të veprimit të kësaj strategjie, konkretisht 2023–2025. Rezultoni se 21 Bashki kanë hartuar dhe janë duke zbatuar planet e tyre të integritetit, ndërkohë që asnjë bashki nuk ka pasur më parë një plan të tillë. Procesi i hartimit të Planeve të Integritetit dhe Kodit Standard të Sjelljes ka ndjekur një qasje vullnetare nga ana e bashkive²⁴ por tashmë është e nevojshme plotësimi i të gjitha bashkive me plane të personalizuar të integritetit.

Krijimi i mekanizmit të brendshëm institucional të strukturave qendrore për monitorimin e demokracisë dhe transparencës vendore Në kuadër të konsolidimit të masave kundër korrupsionit dhe forcimit të demokracisë vendore synohet krijimi i një mekanizmi të brendshëm institucional me qëllim monitorimin dhe eventualisht kalibrimin sipas kontekstit të demokracisë vendore dhe mirëqeverisjes. Në këtë rast Ministri për Pushtetin Vendor dhe Agjencia Për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV) kanë rol kyç për të monitoruar produkte të lidhura me këtë fushë, për shembull planet e integritetit, programin e transparencës etj. Ndaj është i nevojshëm krijimi i një mekanizmi të qëndrueshëm, jo ad-hoc, për monitorimin e elementeve të demokracisë vendore dhe luftës kundër korrupsionit, ku është i mundur duke konsideruar edhe integrimin e elementit gjinor dhe jo diskriminimin. Kjo kërkon së pari evidentimin e këtyre elementeve, në koordinim edhe me institucione qendrore, vendore apo edhe partnerë zhvillimi (p.sh. Komisioni për të Drejtën e Informimit).

8. Analiza ligjore e gjetjeve të studimit

8.1 Komentet dhe rekomandimet e marra gjatë procesit të konsultimit publik

Legjislatori në nenin 19, të ligjit nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” ka përcaktuar qartë se komentet dhe rekomandimet e marra gjatë procesit të konsultimit publik grumbullohen nga koordinatori i njoftimit dhe konsultimit publik të organit publik përkatës në një mënyrë të strukturuar dhe transparente.

Për më tepër palëve të interesuara u jepet koha e arsyeshme për të dërguar pranë organit publik vendimmarrës komentet dhe rekomandimet e tyre. Afati për dorëzimin e komenteve dhe

²⁴ Bashkitë që kanë hartuar Plane të Integritetit dhe Kodit Standard të Sjelljes janë: Patos, Elbasan, Mallakastër, Mat, Gjirokastër, Durrës, Belsh, Berat, Bulqizë, Lezhë, Përmet, Pogradec, Tiranë, Lezhë, Shijak, Maliq, Has, Kukës, Pukë, Kavajë, Himarë, Roskovec.

rekomandimeve zakonisht përcaktohet brenda 20 ditëve pune nga data e njoftimit për procesin e njoftimit paraprak dhe brenda 20 ditëve pune nga data e njoftimit për procesin e njoftimit e të konsultimit publik.

Nga monitorimi i procesit, bashkitë në fokus të këtij studimi nuk respektojnë afatet për ti dhënë palëve të interesuar kohën e arsyeshme për të dërguar pranë organit publik vendimarrës komentet dhe rekomandimet e tyre. **Psh në Bashkinë e Vlorës njoftimi postohet me datën 16 Prill 2024, ndërkohë që takimi është planifikuar me datë 17.04.2024 ora 18.00 Pallati i Kulturës "Labëria"**²⁵ E njëjta situatë ndodh edhe në Bashkinë Durrës, ku njoftimi për dëgjuesën publike publikohet më 15 maj, ndërsa sugjerimet dhe komentet nga publiku pranohen përmes postës elektronike deri më 25 maj 2024.²⁶

Gjithashtu, nënvizojmë se në të gjitha bashkitë e monitoruara, afatet ligjore për marrjen e sugjerimeve apo komenteve mbi projekt-aktet e konsultuara nuk njihen ose nuk respektohen nga stafet e bashkive dhe/ose Këshillave Bashkiakë. Në pjesën më të madhe të bashkive, rekomandimet jepen gjatë dëgjësave publike, ballë për ballë me komunitetin, por nuk ka evidenca të qarta se sa prej tyre janë marrë parasysht ose janë reflektuar përmes ndryshimeve në draftin final të projekt-aktit.

Prandaj është domosdoshmëri zbatimi i një detyrimi të tillë i cili i **shërben rritjes së përgjegjshmërisë së autoriteteve lokale dhe krijimit të besueshmërisë ndaj publikut duke zbatuar një nga parimet bazë të procesit të konsultimit**

8.2 "Stacioni" ligjor për grumbullimin e komenteve dhe rekomandimeve

Dy janë "stacionet" kryesore të përcaktuara nga ligji ku palët e interesuara mund të dërgojnë komentet dhe rekomandimet e tyre:

1. *Regjistri elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike*²⁷
2. *Koordinatori i njoftimit dhe konsultimit publik*²⁸

1. Regjistri elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike

Sipas përcaktimit ligjor çdo projektakt publikohet në regjistrin elektronik për njoftimin dhe konsultimin publik. Ky regjistër është një faqe zyrtare interneti, e cila shërben si një pikë qendrore konsultimi, dhe nëpërmjet këtij regjistri sigurohet akses dhe ofrohet mundësia e komunikimit të të gjitha palëve të interesuara me organin publik. Kjo formë siguron dhe forcon barazinë për sa i përket aksesit në informacion dhe shërbim, duke pasur në vëmendje dhe nevoja specifike për persona apo grupime të caktuara.

Po ashtu nëpërmjet **VKM Nr. 828, datë 7.10.2015**, janë miratuar rregullat për krijimin, administrimin dhe monitorimin e Regjistrit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike. Çdo

²⁵ Shih njoftimin në faqen e Bashkisë Vlore <https://vlora.gov.al/njoftim-per-degjese-publike-4/>

²⁶ <https://durrës.gov.al/wp-content/uploads/2024/05/Njoftim-publik-per-konsultim-me-publikun-parkimi-Durrës-1.pdf>

²⁷ Neni 7 i ligjit nr. 146/2014 "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik"

²⁸ Neni 10 i ligjit nr. 146/2014 "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik"

organ publik i ngarkuar për zbatimin e ligjit nr. 146/2014, "Për njoftimin dhe konsultimin publik", duhet të caktojë një punonjës të administratës, përgjegjës për të grumbulluar, sistemuar, përshtatur dhe hedhur në formatin e duhur, në faqen e web-it, të gjitha projektaktet e iniciuara nga të gjitha strukturat dhe departamentet e institucionit përkatës, si edhe për të bërë përditësimin e vazhdueshëm të regjistrit.

Studimi në bashkitë e targetuara të rrjetit POP tregoi se regjistri elektronik administrohet nga sekretariati i Këshillit Bashkiak dhe publikohet në faqen e internetit të çdo bashkie, në seksionin e regjistrave të këshillave bashkiakë. **Vetëm Bashkia Tiranë** ka një regjistër të brendshëm, ndërsa të gjitha bashkitë e tjera, në përgjigjet e kthjera nga kërkesat për informim, kanë referuar regjistrat e projekt-akteve për konsultim me publikun që publikohen në seksionet e këshillave bashkiakë. Vlen të përmendet fakti se në të gjitha regjistrat e konsultuar për studimin, nuk paraqiten vërejtjet dhe rekomandimet që qytetarët apo grupet e interesit paraqesin gjatë dëgjësive publike dhe nuk është e qartë se sa nga këto rekomandime merren parasysh në draftin final të projekt-akteve.

Nga monitorimi i Bashkive rezulton se rregjistri elektronik në shumë raste nuk pasurohet me të gjitha projektaktet dhe në raste të tjera informacioni nuk është i plotë dhe i qartë. **Psh në Bashkinë Korçë për periudhën 2023-2024 figurojn gjithsej 5 vendime²⁹ ku konstatohet lehtësisht se në disa raste edhe afatet ligjore të njoftimit nuk respektohen. Edhe bashkia Pukw, ka tw publikuara vetwm tre vendime³⁰ dhe materialet shoqwruese mungojnw.**

Nga 9 bashkitë e monitoruara, vetëm Bashkia Tiranë ka një regjistër të brendshëm të konsultimit publik, i cili nuk është i hapur për publikun. Ndërsa në të gjitha bashkitë e tjera, regjistri publikohet dhe përditësohet nga Këshilli Bashkiak. Regjistrat e projekt-akteve të konsultimit me publikun, me informacion të përditësuar, publikohen nga Këshillat Bashkiakë të Durrësit, Kukësit, Elbasanit, Vaut të Dejës, Shkodrës, etj. Ndërsa regjistrat në bashkitë e tjera kanë nevojë të përditësohen me informacione dhe të dhëna.

2. Gjithashtu në kuadër të Programit të Transparencës, miratimi i rishikimit të këtij programi në pikën 6 të tij, duhet të parashikojë informacionet dhe procedurat e pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje, ku përfshihet dhe publikimi i rregjistrit elektronik i akteve vendore që i nënshtrohen konsultimit publik dhe nismave qytetare. Ndaj për të përmbushur detyrimet e tyre bashkitë duhet të përditësojnë informacionet në mënyrë periodike dhe të unifikuar. **Koordinatori i njoftimit dhe konsultimit publik**

Çdo organ publik cakton një person si koordinator të njoftimit dhe konsultimit publik, i cili është përgjegjës për bashkërendimin dhe administrimin e përgjithshëm të punës për garantimin e së drejtës së njoftimit e të konsultimit publik. Komentet dhe rekomandimet e marra gjatë procesit të konsultimit publik grumbullohen nga koordinatori i njoftimit dhe konsultimit publik të organit publik përkatës në një mënyrë të strukturuar dhe transparente. Nga monitorimi i Bashkive rezulton se njoftimet në lidhje me procesin në raste të caktuara figuron adresa e email e

²⁹

<https://docs.google.com/spreadsheets/d/1UYq08gHYMKzLUkpFPmSmrxxgp-eEa5kX1rWOO3cgW5c/edit?gid=0#gid=0>

³⁰ <https://bashkiapuke.gov.al/regjistri-i-projekt-akteve/>

Kordinatorit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik dhe në raste të tjera vendosen adresa tjera email për dërgimin e komenteve³¹

Po ashtu ka edhe raste kur njoftimet për Konsultim Publik nuk përcaktojnë asnjë adresë email, asnjë dokument të projektaktit si dhe asnjë afat³²

Në disa bashki, koordinatori i njoftimit dhe konsultimit publik nuk është emëruar ende, në të tjera mban dy funksione atë të informimit dhe njoftimit e konsultimit publik dhe në bashki të tjera ka një urdhër të brendshëm për emërimin e tij. Vetëm në disa bashki detyrat dhe rolet e tij janë të pasqyruara dhe në rregulloret për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së bashkisë.

Nga monitorimi i realizuar, ka bashki që ende nuk kanë një koordinator për njoftimin dhe konsultimin publik (Bashkia Pukë, Vau i Dejës), ndërsa në raste të tjera, këtë pozicion e mbulon koordinatori për informimin publik (Bashkia Korçë, Fier). Bashkitë që kanë koordinator të Konsultimit Publik janë Vlorë, Shkodër, Kukës, Elbasan, dhe Tiranë. Në pak raste, detyrat dhe përgjegjësitë e koordinorit janë të sqaruara në rregulloren e funksionimit të bashkisë përkatëse. Zakonisht, koordinorët janë specialistë që mbulojnë edhe detyra të tjera në bashki. Sa i përket Këshillave Bashkiakë, anëtarët e sekretariatit janë ata që regjistrojnë dhe përgatisin raporte, të cilat publikohen në regjistrat elektronikë.

8.3 Raportet për transparencën në procesin e vendimmarrjes

a) Afatet në procesin e konsultimit:

Gjatë periudhës së konsultimit, nisur nga rëndësia e projektaktit dhe interesi i lartë publik, organi publik mund të organizojë takime publike, ku palët e interesuara paraqesin opinionin e tyre dhe të dhëna për projektaktin që do të hartohet. Palëve të interesuara, të ftuara për të marrë pjesë në takimet publike, u jepet koha e nevojshme për përgatitje. Në çdo rast, ato informohen **jo më pak se 20 ditë pune** përpara takimit publik, duke u vënë në dispozicion kopje të projektaktit që do të diskutohet. Për akte veçanërisht komplekse ose të rëndësishme, sipas vendimit të organit publik, **afati për dërgimin e komenteve mund të zgjatet deri në 40 ditë pune** nga data e njoftimit.

Në disa bashki nuk respektohen afatet për njoftimin në konsultimet publike. **Psh në Bashkinë e Vlorës njoftimi postohet me datën 16 Prill 2024, ndërkohë që takimi është planifikuar me datë 17.04.2024 ora 18.00 Pallati i Kulturës "Labëria"**³³

b) Shqyrtimi i komenteve dhe rekomandimeve:

Shqyrtimi i komenteve dhe rekomandimeve kryhet nga organi publik përgjegjës për hartimin e projektaktit, i cili vendos për pranimin ose refuzimin e rekomandimeve të marra nga palët e

³¹ Shih njoftimin e bere nga Bashkia Shkoder ku adresa email nuk I perket kordinatorit per informimin dhe konsultimin publik https://bashkiashkoder.gov.al/k%C3%ABshillim_m_publikun/njoftim-per-keshillim-me-publikun-nga-keshilli-bashkiak-4/ dhe njoftimin https://bashkiashkoder.gov.al/k%C3%ABshillim_m_publikun/njoftim-per-keshillim-me-publikun-per-draftin-e-projektplanit-buxhetor-afatmesem-2024-2026/

³² Shih njoftimin e bere nga Bashkia Shkoder https://bashkiashkoder.gov.al/k%C3%ABshillim_m_publikun/njoftim-per-konsultim-te-projektit-te-plote-rehabilitimi-ndertimi-i-tre-3-moleve-shkoder-shiroke-dhe-zogaj/

³³ Shih njoftimin ne faqen e Bashkise Vlore <https://vlora.gov.al/njoftim-per-degjese-publike-4/>

interesuara të konsultuara. Projektaktet shoqërohen me një përmbledhje të rekomandimeve të pranuar, sipas dispozitave të këtij ligji. Nëse rekomandimet e palëve të interesuara nuk janë pranuar, atëherë organi publik paraqet një përmbledhje të arsyeve për mospranimin e tyre.

Nga monitorimi i organizatave partnere ne Bashkitë të cilat janë në fokus të këtij studimi rezulton se pothuajse në të gjitha Bashkitë nuk ka kopje të projektakteve të shoqëruar me një përmbledhje të rekomandimeve të pranuar, dhe përmbledhje të arsyeve për rekomandimet e palëve të interesuara që nuk janë pranuar në zbatim të nenit 19 të ligjit Nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”

c) Hartimi i Raportit për transparencën në procesin e vendimmarrjes

Ligji Nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, në nenin 20 të tij i ngarkon organet publike me detyrimin për të hartuar dhe publikuar raporte vjetore për transparencën në procesin e vendimmarrjes. Në këto raporte duhet të përfshihet informacion për:

- *numrin e akteve të miratuara nga organi publik përkatës gjatë vitit referues;*
- *numrin e përgjithshëm të rekomandimeve të marra nga palët e interesuara;*
- *numrin e rekomandimeve e të komenteve të pranuar dhe të refuzuara gjatë procesit të vendimmarrjes;*
- *numrin e takimeve publike të organizuara.*

Nga monitorimi i organizatave partnere rezulton se pothuajse në të gjitha bashkitë mungon raporti vjetor në lidhje me procesin e konsultimeve në zbatim të nenit 20 të ligjit Nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”. Përrjashtim deri diku bën Bashkia Vlorë raporti është dorëzuar në hardcopy ndonëse nuk është i publikuar online. Ndërkohë Bashkia Elbasan e cila ka publikuar raportin vjetor për transparencën në vitin 2021³⁴ i mungojn elementet formal të një dokumenti zyrtarë të tillë si data, numër protokolli firma, vula etj. Nga ana tjetër nuk rezulton të ketë patur raporte për vitet e tjera pasardhëse, përkatësisht 2022 dhe 2023.

Tabela përmbledhwse e bashkive.Për të vlerësuar efektivitetin e transparencës së procesit të konsultimit publik, rrjeti POP bazuar në metodologjinë e studimit hartoi dhe shpërndau: (i) Kërkesa për informacion drejtuar bashkive; (ii) realizoi intervista të thelluara me staf të bashkive dhe anëtarë të Këshillit Bashkiak; (iii) monitoroi publikimet në faqen e internetit të bashkisë dhe raporte alternative të prodhuara nga palë të treta; (iv) asistoi nga afër konsultime publike nga nxjerrja e projekt-aktit deri në miratimin përfundimtar të tij.

Organizatave partnere të rrjetit POP përgatitën kërkesa për informacion, ku përgjigjet janë dhënë brenda afateve ligjore me email dhe dokumentacion shkresor. Në lidhje me informacionin mbi “Zbatimin e proceseve të ligjit të Njoftimit dhe Konsultimit Publik, për periudhën shtator 2023-maj 2024”, personat përgjegjës dhe koordinatorët për njoftimin dhe konsultimin public, bazuar

³⁴ Shih Raportin për Transparencën dhe Konsultimet Publike 2021 të Bashkisë Elbasan <https://elbasani.gov.al/raporte-te-keshillit-bashkiak/>

në ligjin 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ligjin nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, vendosën në dispozicion informacionin që është pasqyuar në tabelën më poshtë. Gjithashtu në tabelën përmbledhëse gjeni informacion dhe një vlerësim shprehet me i/e realizuar plotësisht, pjesërisht, aspak. Komente rreth gjetjeve nga monitorimi janë në dispozicion të lexuesve të këtij raporti, me qëllim për të vlerësuar efektivitetin e procedurave që zbatohen nga bashkitë e monitoruara në linqet e raporteve përkatës.

9. Konkluzione dhe Rekomandime:

Bashkitë në funksion të zbatimit të principeve të procesit të konsultimit publik *për të qënë transparente të përgjegjshme dhe efektive në procesin e vendimarrjes lokale rekomandohet që:*

1. Për të rritur shkallën e transparencës Bashkitë duhet:

- a) Të rishikojnë programet e transparencës në zbatim të nenit 5 të ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” ku të përshkruhet në mënyrë sa më të qartë dhe të strukturuar pjesmarrja e publikut në vendimarrjen lokale.
- b) Të publikojnë raportet vjetore në lidhje me procesin e konsultimeve në zbatim të nenit 20 të ligjit Nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” *gjatë procesit të njoftimit e të konsultimit publik.*
- c) Të publikojnë të gjitha informacionet e nevojshme në Rregjistrin Elektronik të projektakteve për Konsultim Publik
- d) Të jepet **informacion i qartë dhe i detajuar** mbi procesin e njoftimit dhe konsultimit publik në të gjitha fazat, duke filluar nga publikimi i projekt-aktit, afatet për marrjen e komenteve dhe rekomandimeve, organizimin e debateve publike e deri te miratimi i aktit përfundimtar

2. Për të rritur shkallën e efektshmërisë Bashkitë duhet:

- a) Të **standartizojnë procesin e konsultimeve** publike përmes rregulloreve dhe procedurave vendore të cilat garantojnë përfshirjen e qytetarëve në proceset e vendimarrjes vendore. Bashkitë dhe stafet përgjegjëse për realizimin e këtyre proceseve duhet të kenë në dispozicion rregullore dhe procedura standarde dhe të miratuara në këshillin bashkiak të cilat do ta lehtësonin dhe përmirësonin këtë proces.
- b) Të **respektojnë afatet për njoftimin në konsultimet publike** duke zhvilluar sesione informimi paraprake që sensibilizojnë komunitetin mbi rëndësinë e pjesmarrjes në konsultime publike.
- c) Të **ndërtohen partneritete dhe mekanizma të thjeshte dhe efektiv të pjesëmarrjes dhe angazhimit qytetar** që sigurojnë njerëzve mundësinë për të ndikuar në përdorimin e autoritetit dhe përgjegjësiive lokale.
- d) Të **përdoren platforma elektronike**, që mundësojnë në mënyrë demokratike dhe transparente përfshirjen sistematike të komunitetit në veprimtarinë dhe në vendimarrjen e këshillit bashkiak.

3. Për të rritur shkallën e përgjegjësisë Bashkitë duhet:

- a) **Të rrisin kapacitetet e personave përgjegjës në bashki** si një domosdoshmëri që ndikon drejtpërsëdrejti në përmirësimin e të gjithë proceseve që lidhen me qytetarët.
- b) **Të forcojnë Rolin e Kordinatorit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik** duke i dhënë gjithë mbështetjen e duhur për lehtësimin e marrjes së komenteve nga grupet e interesit
- c) **Të krijojnë të gjitha hapsirat e nevojshme** për komunitetin, grupet e interesit, shoqërinë civile në monitorimin e zbatimit të politikave vendore.
- d) **Të publikojnë kopje të projektakteve** të shoqëruar me një përmbledhje të rekomandimeve të pranuar, dhe përmbledhje të arsyeve për rekomandimet e palëve të interesuara që nuk janë pranuar në zbatim të nenit 19 të ligjit Nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”

10. Referencat:

10.1 Burime parësore

- Karta Europiane e Autonomisë Vendore
- Ligji nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”
- Vendimi nr. 29, datë 21.12.2006 i Gjykatës Kushtetuese Shqiptare,
- Vendim Nr. 252, datë 20.4.2023, “Per Miratimin e Strategjise Ndersektoriale per Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023–2030, te Planit te saj te Veprimit 2023-2025 e te pasaportes se indikatoreve”
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 828/2015 “Për miratimin e rregullave të krijimit dhe administrimit të regjistrit elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 584/2003 “Për miratimin e Rregullores së Këshillit të Ministrave”.
- Urdhri i Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, nr. 3/2021, “Për miratimin e udhëzuesit për procesin e konsultimit publik”;
- Zyra e Kryeministrit "Metodologjia për Vlerësimin e Ndikimit Rregullator (2018)".
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 584/2003 "Për miratimin e Rregullores së Këshillit të Ministrave"
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 539/2019 “Për miratimin e udhërrëfyesit për politikën qeverisëse drejt një mjedisi mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile 2019–2023”. <http://www.amshc.gov.al/web/doc/Udherrefyesi-2019-rishikuar.pdf>
- Regjistri Elektronik i Konsultimit Publik: <https://www.konsultimipublik.gov.al/>
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 828/2015 “Për miratimin e rregullave të krijimit dhe administrimit të regjistrit elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike”
- Urdhri nr. 3, datë 29.01.2021 i Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e udhëzuesit për procesin e konsultimit publik” <https://www.adisa.gov.al/wp-content/uploads/2021/03/URDHER- Nr.-3-Dt.-29.01.2021-compressed.pdf>

10.2 Burime dytësore:

- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (2018) Raport Vlerësimi i kapaciteteve të koordinatorëve të së drejtës së informimit dhe njoftimit dhe konsultimit publik
- Res Publica (2017) Komentar i Ligjit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik <https://www.publeaks.al/wp-content/uploads/2017/11/Res-Publica-Komentar-i-ligjit-per-njoftiin-dhe-konsultimin-publik.pdf>
- SIGMA Konsultimi – Një mjet kyç për rregullim më të mirë në Evropë dhe Rumani <https://www.sigmaweb.org/publicationsdocuments/41838190.pdf>

11. Aneksë: Raportet Studimore të Bashkive Tiranë, Durrës, Vlorë, Pukë, Elbasan, Fier, Kukës, Shkodër, Vau i Dejës, Korçë, “Transparenca dhe Përgjegjësia në Nivel Vendor - Vlerësimi i Proceseve të Konsultimit Publik”.

- o <https://popnetwork.al/raporti-studimor-transparenca-dhe-pergjegjesia-ne-bashkine-tirane-vleresimi-i-procese-ve-te-konsultimit-publik/>
- o <https://popnetwork.al/raport-studimor-transparenca-dhe-pergjegjesia-ne-bashkine-durres-vleresimi-i-procese-ve-te-konsultimit-publik/>
- o <https://popnetwork.al/raport-studimor-transparenca-dhe-pergjegjesia-ne-bashkine-fier-vleresimi-i-procese-ve-te-konsultimit-publik/>
- o <https://popnetwork.al/raport-studimor-transparenca-dhe-pergjegjesia-ne-bashkine-kukes-vleresimi-i-procese-ve-te-konsultimit-publik/>
- o <https://popnetwork.al/raport-studimor-transparenca-dhe-pergjegjesia-ne-bashkine-puke-vleresimi-i-procese-ve-te-konsultimit-publik/>
- o <https://popnetwork.al/raport-studimor-transparenca-dhe-pergjegjesia-ne-bashkine-shkoder-vleresimi-i-procese-ve-te-konsultimit-publik/>
- o <https://popnetwork.al/raport-studimor-transparenca-dhe-pergjegjesia-ne-bashkine-vlore-vleresimi-i-procese-ve-te-konsultimit-publik/>
- o <https://popnetwork.al/raport-studimor-transparenca-dhe-pergjegjesia-ne-bashkine-elbasan-vleresimi-i-procese-ve-te-konsultimit-publik/>
- o <https://popnetwork.al/raport-studimor-transparenca-dhe-pergjegjesia-ne-bashkine-vau-i-dejes-vleresimi-i-procese-ve-te-konsultimit-publik/>
- o <https://popnetwork.al/raport-studimor-transparenca-dhe-pergjegjesia-ne-nivel-vendor-bashkia-orce/>

RRJETI POP

Rrjeti "Përballja e Ofertave Politike – POP", synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve rrjeti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Përballja e Ofertave Politike - POP, është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga "Olof Palme International Center" dhe "National Endowment for Democracy."

KONTAKT

Adresa: Rr."Abdyl Frasheri", P.10/1,
Tirana, Albania

Tel: +355 (0) 422255514

Mobile: +355 69 61 20 169

Email: perballjaeofertavepolitike@gmail.com

Web: <https://popnetwork.al/>